



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN), në përputhje me autorizimet të cilat parashikohen me Protokollin Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese, Ligjin për Avokatin e Popullit dhe Rregulloren e punës së Avokatit të Popullit, më datë 23.03.2012, dërgoi **MENDIM** pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për normat dhe standardet e përgjithshme, të cilat duhet t'i përmbushin ambientet për ndalimin e personave në stacionet policore me kompetencë të përgjithshme.

Avokati i Popullit, si Mekanizëm Parandalues Nacional konsideron se, unifikimi i akteve normative në kontekst të ambienteve për ndalimin e personave në stacionet policore me kompetencë të përgjithshme, konform standardeve të vendosura paraprakisht të cilat i respektojnë të drejtat themelore të njeriut, në mënyrë të konsiderueshme do të kontribuojë në reduktimin e rreziqeve nga torturat e mundshme ose nga trajtimet tjera brutale, jonjerëzore, nënçmuese ose ndëshkuese të atyre personave.

Mendimi i Mekanizmit Parandalues Nacional i përfshin standardet minimale për vendosjen e personit të ndaluar, të miratuara nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT), si dhe përvojat e vendeve nga rajoni.

Mekanizmi Parandalues Nacional konsideron se ndalimi nuk guxon të zbatohet në ambiente bodrumi ose magazine, e as pranë ose në afërsi të drejtpërdrejt të lokaleve ku ruhen armët ose lokale në të cilat ruhen sendet e sekuestruara përkohësisht. Distanca midis mureve në ambientin për ndalim duhet të jetë më së paku 2 m², ndërkohë që ambienti duhet t'i përmbush në mënyrë adekuate edhe masat e domosdoshme të mbrojtjes dhe sigurisë, të ketë ndriçim të drejtpërdrejtë natyror, përkatësisht ajrosje adekuate natyrore dhe artificiale, si dhe ngrohje përkatëse.

Ambienti duhet t'i përmbush parakushtet e domosdoshme, me qëllim që personi të mundet papengesë ta realizojë të drejtën e pushimit gjatë natës. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet masave të sigurisë dhe materialeve ndërtimore të toaletit ku duhet të shmangen sendet të cilat mund të paraqesin rrezik për shëndetin dhe jetën.

Ambientet për ndalim, në çdo stacion policor me kompetencë të përgjithshme, duhet të jenë të shënuara numerikisht, ndërsa me Rregulloren e njëjtë në mënyrë përkatëse duhet të përcaktohen edhe normat dhe standardet e përgjithshme për ambientet në të cilat zhvillohen biseda me personat e privuar nga liria.

Në kontekst të realizimit të plotë të normave dhe standardeve të përcaktuara me Rregullore, në praktikë nevojitet përcaktim i qartë i afateve për ndërtimin ose riadaptimin e ambienteve për ndalim dhe parashikimin e implikimeve buxhetore.